

S H Q I P T A R O S E K U

KRYQUESI I SHPIRTIT

P o e z i

Korrektor-lektor i poezisë shqipe:

Shefki Oseku

Korrekturläsare för dikter i svenska språket:

Marianne Bengtsson

Përpunimi kompjuterik:

Frashër Oseku

**Botuar me ndihmën e Arne Nilsonit, drejtor i ABF-it
në Treleborg – Suedi**

U dorëzua në shtyp në janar të vitit 2002

Tirazhi 1.000 copë

prindërve të mi, të cilët po gjallojnë në mërgim

me dashuri të thellë

V E T Ë R R Ë F I M

Zotynë
dorën e ndihmës më shtrij
ta mund atë tjetrin brenda meje

për çdo mbrëmje më ngulfasin
duart e akullta të zisë
përmbytje penestesh dokleatesh japodesh
në miniaturë

druaj që s'nxjerr dot
poezinë e vërtetë

Zotynë
i druaj një nate të pahënë
kur do të më vjedhin edhe poezinë
hajnnjerëzit

ANTIPOEZI

mos më beso më
as mua
as vetes
as hija jote nuk është jotja
shekulli XX
invencion përgjimi
në krevat
në WC
nëpër rrugë
nën lëkurën tënde
bëhu e huaj
e dashur, askush-askë më
nuk guxon ta dojë
ushtarët e huaj
po i vrasin ndjenjat
ndaj diellit kanë shpallur fletarrestin
jeta jonë e vogël
mund të dënohet
diferencohet
...ohet...!

MESNATË NË GJAKOVË

sonte hëna kullon
lumenj të verdhimtë trishtimi
plot vaj e kujisje

mesnata prehet e pajetë
a sheh
gati mund ta prekësh me dorë

një natë të këtillë
vdekja kalëron e harlisur pafre
lektisja e saj e akullt
gërvishtë terrin
nata e këtillë murmuron rënkueshëm
një lutje përshpirt
shembet
dhe mbaron në heshtje
jashtë qytetit dhëmbërënë të Gjakovës
dikah fushave të paemra
largë veshëve të tu

agu është nemur zi kësaj nate
kur gjithçka rrejshëm flenë

NJË PËRRALLË ILIRE

paramendo, Gjakova
një grusht dhe i butë e një duet
uji
një përrallë ilire

mbi qytet luten kodrat e Çabratit
për të dy anët e horizontit
shqiptar

.

GJAHU I MOÇËM

bisha e qytetit ngrefoset në terr
në sy fsheh etjen për gjak
është koha të fillojë gjahu i moçëm
bashkëshortët nguten te familjet të presin
prindërit druajnë për fëmijët e vonuar
po fillon sërish një gjah i moçëm...

TREGIM QË NUK DHEMB

muzgun e çalë e zgjuan trembshëm
kur vunë kujen
ata që askush më nuk i kujtonte
 mësa ëndërrën e keqe
nga qivuret cullakuan padrejtësitë e kësaj bote
dhe vazhduan ta jetonë vdekjen e tyre rehat

mbi ta – ndjesë paçin
rrezbiten
kryqet e të harruarve padrejtësisht

NJË STINË E PANJOHUR

të katër stinët të lanë
Krujë
gojëdhënë e ngurtësuar
nga pirgjet tua u hodhën
vdekur përdhe

e ti heshte mendueshëm
rrënojë e vjetër kryeneçe
dhe pret të zbardhë
një stinë e pestë
e panjohur

RRËFIMI MBI KRYQUESIN E SHPIRTIT

- studentëve guximtarë të Tiranës

mbi muzgun ngrefosur kalëroi vitet
kukudh i dalë nga pellgje zie
në birëterri i lindur në terr jetoi
(agun e ndaloi me dekret partiak)
ku shkeli ai toka u dergj
netëve rrëmbente tinëzisht orët – nuse
të mbetura sogje mbi fatet e vendit
i rrethonte në togje me telaferra
zërin e tyre në kujë e kthente
gjersa i këndonin veç emrit të tij
nga kështjella e lartë e bronzte sundonte syçelë
derisa vdiq

pas tij
gajtanat e natës mbi tokë u këputen
dy shqipe lëshuan klithma ngashnjimi
(drithma u ndje deri te Kau i Zi)
shgurëzuan plengje dhe krushq e dasmorë
përmendoret bashkë me mite i thërmoi gdhirja
dhe me kujdes vendosi nga një kokërr urti
ndër libra historie

KISHËS SË SHËN KOLLIT

perëndimeve të kallura
ngatërron diellin përgjeve sfidëmëdha
horizontin e plandose në agoni të pritjes

brenda heshtjes së përmortshme të harqeve tua
tinguj kohërash ndeshen egër freskave
duhmojnë fitore të moçme
zëra kremtash
zishë
rrënimesh me themel

breza të lashta murgjish të paemër
ruajnë të fshehtat tua

Me dorën e pikëllimtë të mallit
fërkoj qindvjetëshat e gurëve tu
thërmi të fundit të një miti fatrrëfyës
unë
stërnip i largët i kronikës sate
i ledheve-germadhe e kryqeve të rëna

o kishë e Shën Kollit
unë isha prore këtu
gjëmim ndër faqet e fletëshekujve tu
të mbytur në gjak
mua të vrrarit të lidhurit kryeneçit
lajmpritësit të përhershëm
më thuaj
çfarë përgjoje në shtjellat e së ardhmes
ç'dije vallë qëmoti
pesëqind vjet me parë?

Ç A M E

shtatë palë amshim
të vrara
në ndajnatën kurrizdalë

nëpër gurët pluhurakë
në urën ngashnjyer mbi valë

për një natë ta bënë gjëmën
o Prevezë
e vdekur-e gjallë

.

EKLESIASTIKAL

- imzot Pjetër Bogdanit

gjallojmë vite të stërgjata
të harruara me pabesi
edhe nga vetvetja

buzë flokë bebëza na lëbardhë
vizatim i hirtë
i vdekjes
vijat e tij i trishtojnë nxënësit
u shuan zjarret në gji

Zotynë

gjallojmë vite të përbindshme

QYTETIT TË SARANDËS

ikën
si stuhi të pluhurta
të magjepsur nga shpërfillja jote

për ku rrugëtonin
me emrin tënd mbi shpinë
të dyzetët

pse lanë të ndehet mbi çatitë
vegimi i lodhjes së tyre
të pangushëllim

Sarandë
në ç'kryqëzata vanë vallë
me tranzimin tënd bohem

dyzetë engjujt emërdhënës

.

PA TITULL

e ndryrë në trillin tënd
të kultivuar
tmerrohesh
nga ngulçima ime e fundit
sikur në ankth
veten takon sy me sy

epika është tkurrë
në një grusht mëshire mbi varre
nga dheu stërggjyshor

e till sillesh vërdallë
e braktisur
diku thellë në mua

o kënga shqiptare mbi këngët
disa rrojnë shkurt e vdesin gjatë

merr një dorë vuajtje
nga nëntë mijë rrathët e mia
lehtoma këtë barrë
që prore e mbaj

për ty
o kënga shqiptare mbi këngët

.

AS GJALLË AS VDEKUR

buzëmbremja afrohej
p a s h m a n g s h ë m...

ata dilnin si ujqër të stërlashtë
që u vjedhë vdekjen frymëmarrja jote

kuja e tyre kafshonte natën me tërbim

me gjakun tënd pikë-pikë
magji mallkimi do të bëheshin në rërë
vaji yt
botën do të shndërronte në përrallë ujqërish

e ti
gjithmonë e ndjekur
flije e trembur në shpirtin tim
deri në mëngjesin tjetër
që diku larg ka ngecur

as gjallë as vdekur...

DEJA-VU

Përsëri
për të satën herë
më ra ta shoh një vend magjepës
ku s'do të kthej kurrë më

një si pellg
(a qe sy toke?)
prehej mes blerimit të errtë
si mace e kotur

Që tani
më djegë përbrenda si plagë:

e pashë kalimthi një vend të bukur
s'do ta shoh kurrë më

Triptik I. Merre një gjysmintelektual të freskët ose nxjerre një të vjetër nga ngrirja e thellë. Qëroje, zbraze e lëre të ajroset. Zieje në ujë të ideologjisë derisa të zbutet pak, lëre t'i kullojë etika e morali. Përziej pastaj një pikë raki, një dorë smirë e një dorë pretenciozitet, dhe fërgoji në yndyrë meskine. Grij imtë pak parolla patriotike dhe shtoj mëlmesat demokratike. Mbushe gjysmintelektualin, qepe, e shtrije në një tepsi institucionale. Fute në furrë me nxehtësi mesatare. Kujdes që rreshka të mos i forcohet tepër. Dekorroje me citate të zgjedhura, nga ato që mësohen në Sorbonne, dhe rrethoje me lule servile. Shërbeje me një parti politike të vakët. Bota s'ka për të parë kurrë president më të mirë. (Për kujtim Birger Normanit)

II. Thoshin se atje bëhej Luftë. TV e radioja jepnin pamje të përgjakshme. Njëfarë komandanti u grahte tankeve mbi rrashta njerëzish, që kërcisnin deri te dhoma ime, milionat në arrati, tymi shtëllungë mbi gërmadha. Tmerr i largët. Klithmat e heshtura binin lehtësisht mbi tepihun e butë, mbi kolltukun, te koleksioni i mineraleve mbi komodinë.

III. Gjogë të harbuar shqelmojnë me tërbim të kurthuar në lëmë. Hungërima çjerrëse. Në ajr rrahë ende zemra e trokut të tyre: shtëllunga të kuqe nëpër natë.

.....

këmbët çapojnë mbi asgjë
njeriu ecka edhe mbi asgjë

mos ma vrisni fëmijën

mashtime të ndrojtura
drejt rrethit të vdekjes
në tokë mbi ujë në qiell

mosni fëmijë, aman!

pema e zezë e lemerisë i hap degët

mosni o i i i i

ka mundësi
që këtu të mos jetë fundi
ndoshta

(kushtuar ikanakëve të luftës)

Maj 1999

ELEGJI PËR ARBANINË

Këtu prehet jeta.

Prekëse, djegëse, e dhembshme,
me zor, e vrullshme, e dhunshme,
monotone, e dashur, e bukur,
rrëmbyese, mashtruese, pikëlluese,
e paqëllimtë,
e hidhur, në vuajtje, në mundime,
e shëmtuar, e lumtur, llastare,
shpresëmadhe, e ëmbël, fatprerë,
e gëzuar, e shpifur, e ndjerë,
e pakuptimtë,
në iluzione, në vetmashtrim, në gabim,
e mbytur në lotë, në çaj, në tym duhani,
para ekraneve të televizionit,
e humbur kot, e humbur rrugëve, birucave, stacioneve,
e humbur në mërgim, pa kthim,
e humbur në konferenca të paqes,
pa shpresë, pa shpëtim, pa mbarim,
kryeneçe,
krenare, e përbaltur, me armë në dorë,
e maltretuar, e poshtëruar, e pështyrë,
lakuriqe, e pambrojtur, pa armë në dorë,
e ekzekutuar,
në bark të nënës, nëpër djepa, nëpër varre,
nëpër puse, nëpër pyje, në oborr,
nëpër fusha, nëpër përrocka, në lumenj,
nën qiell të hapur,

te porta e shtëpisë,
te muri,
për shkaqe të panjohura, për shkaqe të mirënjohura,
për shkak të stërgjyshërve, të gjyshërve, të prindërve,
për shkak të grave, të pleqve, të fëmijëve,
për shkak të foshnjes së palindur,
për shkak të foshnjes motake,
për shkak të foshnjes që s'lindi kurrë,
e ndrydhur, e shtrydhur, e shkelur,
e mirë, e keqe, si për inat, si për mahi,
shtazarake, heroike, bukolike,
e nëpërkëmbur, e pamëshirshme, si gjarpëri nën gur,
në gaz, në vaj, me trimëri,
vrastare, á-là Arbani.
Jeta.
Këtu është djepi e varri i saj.
Kalimtar, hesht.
Le të flejë në qetësi.

(Për kujtim të atyre që ranë fli)

ZBATOVA URDHËR

nuk mbaj mend saktësisht se ku e kur u rekrutova
ish kaherë, kam harruar tani
në më morën me dhunë a më joshën me lakmi
me premtime gjakderdhjesh lotësh e gjishë të bymehura
me kërcënim të vdekjes në vend
a me premtime të zgjedhura për lavdi

në fund zbatova urdhër
ashtu si edhe ti

ish kaherë, kam harruar tani

kah vajtëm ku shkuan çfarë mbaruam
me zjarr e hekur mbi tokën e djegur
tejmbanë tek premë e vramë me mëri e mizori
kam harruar o kam harruar tani

fundja unë vetëm zbatova urdhër
- armiku im i vjetër, këtë e kupton veç ti

tanimë as ku jam nuk e di
para portave të këtij Qyteti të humbur kam ngelur
me armën në dorë e me sy të përgjakur për lemeri
nuk e di
në më komanduan këtej që ta vras e ta dhunoj këtë Njeri
e gruan e fëmijët e tij

-këta qen të pafe!
a t'i mbroj
nga qentë e pafe mbi dhe
që donë t'i vrasin t'i dhunojnë

s'e di unë, as e di ti

ne veç urdhëra zbatojmë
armiku im i vjetër, e miku im i ri

kundroj me habi
a është me mua a me ty ai
që turret këtej me armën e ngrehur
- vallë e ka ndërmend të më zhdukë mbi dhe,
të ma ngulë kokën në hu mbi çati
- ja ku më ke! qen i pafe! –
apo është shok i vjetër armësh
që është përmallë të toket përsëri
te kjo luftë e re, te ky varr i freskët, te kjo çmeri –

thuam
athua me kë është ky Njeri

tek mburret matanë me shqytin e lashtë kuqezi
tek qesh si engjull me kamë të përgjakur në dorë
tek falet për Jezun e Shën Mëri
pedant, me Le Monde Diplomatique nën sqetull

për Zotin që është Një
a e di kush vet a e di kë që e di

Më duhet më duhet një Urdhër
ta zbatoj përsëri
ashtu si kemi bërë tash e qëmoti

paj ne veç urdhëra kemi zbatuar në histori
- Unë e Ti
armiq e doras të vjetër, miq e vëllamë të ri
(Stokholm, 29 shkurt 2000)

PUTHJE NË NATËN E VERËS

terri i natës shkëlqen tejpertej
këtë natë vere

një fjollëz e zjarrtë
bie fatprerëse si flutur e gjakosur

pafundet e detit i ndrinë magjishëm
u falë puthjen e parë

dhe shuhet me ngadalë
ndërsa valët mendueshëm murmurojnë

E PA KRYER

më the: do të vi
nga shtatë palë qiej
zbriti në tokë
dashuria

erë e detit pëshpëriste emrin tënd

sot
deti u çmend
shkumon i tërbuar ciklonet e dhembjes

barkën e vetmisë sime
e përkundin
sazet korçare

TË SHTUNËN

koha me nuk pret
mëtej
je vetem ti

thepisjet e epshit tënd
pafundeve të mekjes
ku sillet vërdallë e çmeritur dashuria

patjetër të puthë ethshëm të mallkoj
të doja pafre deri në zhbërje

por kurrsesi

të vdesë për së gjalli
në zgricpin e së shtunës mbrëma

.

GATI ISHA MËSUAR PA TY

dhe kur kthehesh pas ca kohe në shtëpi
të thuhet
gati isha mësuar pa ty

nuk ke kujt t'ia drejtosh pyetjen
Perëndia do të ishte
një zgjidhje tepër e lirë

DEJËZIM I KOHËS

ditë e stërgjatur, e paanë
tërkuzë kjo e sotmja

muzgu e agu
njëri – tjetrin drejt grackës grishin
me vardisje lolosh

syri i verbër i qiklopëve jep mijëra vdekje
pa kutërbime të përnjëhershme
diku tutje
prapa tymit të cigarës

ditë njëmend tepër e tjerrur
kjo e sotmja

VETËM HARRESA

pylli i shkretë
nga dheu buron dritë e kaltër
degët e drunjëve ia dërgojnë
qiellit
porosinë
e heshtjes
sh-sh-sh-t!
në këtë pyll banon vetëm harresa

ZHUBROSJE NATE

ata flejnë
diku nëpër ankthe
gjahtari therr fëmijën e fjetur

i dehuri përmjerrë shi yjesh mbi botën
në cermin e janarit

ata kujisin të stepur

lisat mbi varre tmerrojnë natën
me mendimet e të vdekurve

.

NJË PËRVJETOR

nata pikon yje
e dehur rëndë nga vetmia

diku në zemër reshë një mall i imtë
i një tetori të shkuar
mëshirshëm mbi ne

pikëllimi vjeshtor shtrihet rrugëve
si ofshamë
jeta mblidhet kruspull

e ti dikund buzëqeshë
padiktueshëm

NGA FILMI I BERGMANIT

dreqi sundon dhe bënë me dije
nuk ndërron asgjë
çdo gjë le të jetë si më parë
feja e lustrat të mos prekën

një votë epshit
me një djallë
dhe ca yje që bien prej qiellit

vallë, është e mundur
ta humbësh veten
copë e grimë

nuk është aq e lemeritshme
nëse mendon kthjelltë

.

STOKHOLMI

parafytyroje Stokholmin
një grusht dritë e gurë
që lazdohen mbi ujë
lidhur me penj të hollë

dhe peshq

.

ARRATIA E POETIT

sot
poeti befas e pa

diellin e zharitur në ethe

rigen herake të një shiu
ende të parënë
hapjen marramendëse të reve

i mbylli sytë

dhe pa i hapur kurrë më
gjalloi me diellin ndër bebëza

.

Jeta shpesh është një ëndërr

LIVET ÄR OFTA EN DRÖM

ËSHTE E MUNDUR

Njeriu mbase formohet me pahir
Mbyllja ime ndofta varet
Prej qyteteve dhe fshatrave të zbrazura të vendit tim

Kush e di
Fati im ndoshta mund të ftillohet
Nga terratisja e rrëzimi i hyjnive ilire
Mijëra vjet më parë
Përmes së ekuacioneve të reja të teorisë së kaosit

Ndoshta është si ajo puna e rathëve në ujë.

DET ÄR MÖJLIGT

det är möjligt
man kanske formas ofrivilligt
min inåtvändhet kanske beror
på mitt lands uttömda städer och glömda byar
på mitt folks ohörsammade böner

vem vet
mitt öde kanske kan förklaras
med illyrgudarnas skymning och fall
för tusentals år sedan
genom nya ekvationer av kaosteorin

det kanske är som med ringarna på vattnet

PËRFUNDIM

Secili e ka fatin e vet në dorë

Kthjellët e qartë

S'ke pse beson në farë fortuna ndërrimesh

Ato s'janë aq të përpikta

Ato s'kanë empati për ty

Për ty s'lodhet njeri

Në kohën e sotme mund t'i besosh veç vetes

Secili e ka fatkeqësinë e vet në dorë

Kthjellët e qartë.

.

Terri dendësohet e dridhet sonte
Vibron si violinë e ligë

Po afron moti kur gjithçka do të fillojë
Zanafilla
Mijëra vjet para lindjes së hyjnive

Terri dridhet e kujisë sonte
E përhapë dhembjen e vet të pashpjegueshme mbi tokën
Në qiej e ujëra e njerëz

Pas të sotmës ndofta s'do të gdhijë më.

.

Ti ndalon
Mëdyslesh e zbrapsesh
Në njohje
E zgjuar
Jashtëzakonisht e kujdesshme

Unë dua t'i mbyllë sytë e ta di që mbetesh pranë

Ndërsa ti më shikon me kokën shtrembër
Dhe e pyet veten si fëmijë
Kush është ky njeri
Çfarë do prej meje

SAMMANFATTNING

var och en är sin lyckas smed
klart och tydligt
man skall inte tro på någon stormande förändring
de är aldrig tillräckligt systematiska
de saknar inlevelse

det är inte dig det handlar om

i dessa tider kan man bara lita på sig själv

var och en är sin olyckas smed
klart och tydligt

mörkret tätnar och skälver i natt
vibrerar som en ond fiol

nu nalkas tiden då allting skall börja
begynnelsen
tusentals år före gudarnas födelse

mörkret skälver och kvider i natt
breder ut sin outsägliga smärta på jorden
på himlar och vatten och människor

det kanske inte gryr efter inatt

du stannar
du tvekar och ryggar tillbaka
igenkännande
vaken
ytterst försiktig

jag vill kunna blunda och veta att du är kvar

medan du ser på mig med huvudet på sned
och undrar som ett barn
vem är han
vad är det han vill

.

ARRATIA

Thonë se unë s'e paskam zgjedhur
por ajo më paskësh zgjedhur mua
protestoj:
ne kishim një relacion të fortë
ekzistonte një mundësi për të zgjedhur
mes Jetës e Vdekjes
dhe unë vendosa vet

më lëndon nëse e harron këtë

Fol ngadalë të lutem
Dua ta njoh secilën fjalë
Të miqësohem me të

Dua të luaj me to
T'i shtrëngoј në përqafim të ngrohtë
Si fjala Përqafim

Dua ta ndjejë njelmësinë e një Loti
Ta parandjej lëvizjen prapa një Buzëqeshjeje

Fol ngadalë të lutem
Lipset kohë për ta mësuar një alfabetin të ri.

Dikush do t'i paguajë
Fshehtësitë e mia

Të gjitha ato herë kur kam ngrënë e pirë
Kur kam fjetur e qeshur nga inati

Jetën time dikush do ta paguaj

FLYKTEN

det säger att jag inte valde den
utan att den valde mig
jag protesterar:
vi hade nog ett ömsesidigt förhållande
det fanns någonstans ett val
mellan Liv och Död
och jag tog det

du sårar mig om du glömmer det

prata sakta snälla du
jag vill lära känna varenda ord
bli vän med dem

jag vill kunna leka med dem
omfamna dem i en stor kram
som i ordet Kram

jag vill känna saltspåren efter en Tår
ana rörelsen bakom ett Leende

prata sakta snälla du
det är svårt att ta till sig ett nytt alfabet

någon skall betala
mina hemligheter

alla de gånger då jag har ätit och druckit
då jag sovit och då jag skrattat av vrede

mitt liv skall någon få betala

.

KËSHILLË PËR DASHNORË

Çapit me vëmendje
Në maje gishtash
Je në një gojëdhënë të panjohur
Ku duhet t'i ftillosh shenjat e fshehtë
Si nuset e Mesdheut
Me zemër

E dëgjo
Ndjeki monopatet e zërit
Dhe një melodi

E nëse nuk ke vdekur ende
Do ta shohësh me një sy
Një alltar me pasqyrimin tënd të bukur

.

RÅD TILL ÄLSKARE

träd in försynt
på tåspetsarna
du är i en främmande berättelse
där du tyder dolda tecken
som brudflickorna vid Medelhavet
med hjärtat

så lyssnar du
följer tonfallets branta stigar
och en melodi

och om du inte stupat än
ser du i ett öga
ett altare med dina fagra spegelbild

Më kujtohet fort mirë
Ishte mars, 1989
Gjethët vareshin mes qiellit e tokës
Dheu që mbuluar nga pluhuri i bardhë
Ajri kutërbonte vdekje
Retë mirrin frymë me vështirësi
Vjeshtë e vërtetë, që ta dish

Më kujtohet fort mirë
Lutjethirrësi e vajtonte ungjillin e Zotit
Mbi qytetin e dhunuar
Këmbanat e kishës tingëllonin si vërejtje

Kryqet e rrasat e varrit vështronin memece si fëmijë të trembur
në mars 1989

jag minns så väl
det var i mars 1989
löven hängde mellan himmel och jord
marken var täckt av vitt damm
 luften stank av död
molnen andades tungt
en riktig höst må du tro

jag minns så väl
böneutroparen begrät Guds evangelium
över den våldtagna staden
kyrkklockorna spred ut en varning

kors och gravstenar blängde stumt som förskrämda barn
i mars 1989

NË KOPSHTIN E MËMËGJYSHËRVE

Mëmëgjyshja kishte bërë petulla kur vdiqa unë
Për kaftjall kish gjithëmonë petulla të dielave
Mëngjeset ishin memece në shtëpinë e gjyshërve të mi ku
heshtja
Vallëzonte mbi çati. Ishin pleq dhe me kalimin e vjetëve edhe
fjalët
ishin zhdukur, si barrë e panevojshme që zbulohet pas largimit
nga porti
e hedhet përposhtë nga një kapiten i rreptë. Ata s'kishin nevojë
për fjalë për ta vënë në pah të qenurit e njëri-tjetrit.

Sigurisht do të kenë ngrënë në kuzhinë. Do të kenë përtypur
kafshata të vogla e do të kenë shikuar përmes dritares në
kopsht. Ishin të brengosur. Kopshti ngrinte ende pas një dimri të
gjatë.

Tokës i duhet kohë për t'u ngrohur e për të dhënë diçka.
Pastaj do të kenë ndejtur ulur një çast të gjatë, para se gjyshi të
dilte për t'i coptuar drutë. I kishte thënë gjyshes se rryma
elektrike nuk nxente dot njësoj, e ajo s'kish pasur zemër ta
kundërshtojë. Pos kësaj, gjyshes i duhej pak kohë për vetveten,
sa për t'i larë enët e dytnisë vetmitare.

Ish e dielë herët dhe ish ende
shumë ftohtë e këmbanat tërhiqnin vërejtjen ndaj
një dite të re kur vdiqa. Tre vjet me radhë ishin përherë aty
në mëngjeset e të dielave. Koha rrinte ulur këmbëkryq
në kopshtin e gjyshëve të mi dhe i shikonte,
ashtu siç e shikonin ata atë. Nganjëherë i buzëqeshnin njëri-
tjetrit në njohje.

Kur mbaroi gjithçka, kur u lodhën pleqtë
e deshën ta kthejnë shpinën e të vejnë, atëbotë Koha i
mbështolli duart.

Ajo kish mbaruar, e unë pendohem që s'isha
me pleqtë të dielën e fundit para se të vdisnin.

I MORFÖRÄLDRARNAS TRÄDGÅRD

Mormor hade sannolikt gjort pannkakor när jag dog. Det var alltid pannkakor till frukost på söndagsmorgnarna. Morgnarna var ordlösa i mina morföräldrars hem, där tystnaden dansade på taket. De var gamla, och med åren hade även orden kommit bort, som en onödig barlast som upptäcks efter avfärd och kastas överbord av en sträng kapten. De behövde inte ord för att främja varandras existens.

De åt sannolikt i köket. De tuggade i sig små portioner och tittade ut genom köksfönstret i trädgården. De var bekymrade. Trädgården frös fortfarande efter en iskall vinter. Jorden behöver tid för att värmas upp och ge. Sedan satt de sannolikt en kort långstund bara, innan morfar gick ut för att hugga ved. Han hade anförtrott sig till mormor att elen aldrig kunde sprida samma värme, och hon hade inte haft hjärta att säga emot. Dessutom behövde hon tid för sig själv, för att skölja tvåsamhetens kärl.

Det var en tidig söndagsmorgon, det var fortfarande mycket kallt och kyrkklockorna varnade för ännu en ny dag när jag dog. I tre år därefter fanns de alltid där på lördagsmorgnarna. Tiden satt med korslagda ben i mina morföräldrars trädgård och betraktade dem, som de betraktade henne. Ibland log de mot varandra igenkännande.

När allt var över, när åldringarna blev trötta
och ville vända sig bort och gå, då slöt tiden sina händer
Den var slut, och jag ångrar att jag inte kunde vara med
De gamla den där sista söndagen innan de dog.

VËREJTJE

Në ëndërr gjithçka është e mundur
Ke mendjen
Jeta shpesh është ëndërr e ligë.

VARNING

i en dröm är allting möjligt
se upp
livet är ofta en ond dröm

S H Q I P T A R O S E K U

KRYQUESI I SHPIRTIT

P o e z i

Korrektor-lektor i poezisë shqipe:

Shefki Oseku

Korrekturläsare för dikter i svenska språket:

Marianne Bengtsson

Përpunimi kompjuterik:

Frashër Oseku

**Botuar me ndihmën e Arne Nilsonit, drejtor i ABF-it
në Treleborg – Suedi**

U dorëzua në shtyp në janar të vitit 2002

Tirazhi 1.000 copë



SHQIPTAR OSEKU

U lind në Gjakovë më 19.10.70 Shkollën fillore dhe gjimnazin e kreu në Gjakovë. Së bashku me familjen emigroi Suedi më 16. 04. 1989. Ka studjuar në Institutin për punë sociale, në Stokholm-Suedi. Tani punon si punëtor social në Stokholm. Është publicist dhe bashkëpunëtor i shumë gazetave, ku ka trajtuar tema të mprehta të aktualitetit politik shqiptar, sidomos atij kosovar. Aktualisht është anëtar i redaksisë së Revistës DRITA, që botohet në Treleborg - Suedi.

Kjo vepër për herë të parë u botua në vitin 2000.
Ky është botim i dytë, i përmirësuar.